REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 27/17
Datë/Datum. 10.02.2017
PRISHTINË - PRIŠTINA

Republika e Kosovës

Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

AKT PËRCJELLËS

Për:	Menaxherin e prokurimit: **"Komunës së Prizrenit".**	Kopje:	Paneli Shqyrtues – **OSHP Nr. 27/17.**
Nga:	Edona Sheqerolli – Ekspert Teknik Visar Bibaj - Ekspert shqyrtues		
Lënda:	Ekspertiza për lëndën **"Hartimi i hartes zonale per Komunen e Prizrenit"**, me nr. të Prokurimit: **622 16 109 421**		
Përgjigjeje në ankesë:	**NTP "PRIMA ENGINEERING"– Prishtinë**		
Datë			**10.02.2017**

Bazuar në nenin 114 të LPP-së ju njoftojmë me Raportin e ekspertizës, lidhur me Ankesen e parashtruar nga OE **NTP "PRIMA ENGINEERING"**– Prishtine, kundër AK – **Komunës së Prizrenit,** lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **"Hartimi i hartes zonale per Komunen e Prizrenit"** me nr. të Prokurimit: **622 16 109 421.**

AK, është i thirrur që pas marrjes së raportit të ekspertit shqyrtues lidhur më këtë procedurë të prokurimit përkatësisht pretendimeve të bëra në ankesë, të veprojnë sipas kërkesave të nenit 115 të LPP-së.

1x1 Panelit Shqyrtues të OSHP-së.
1x1 Autoriteti Kontraktues.
1x1 Operatorit ekonomik ankues.

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES - TEKNIK

		01.02.2017		06.02.2017		10.02.2017
Nënshkrimi i ekspertit		*Data e autorizimit të eksp.*		*Data e fillimit të ekspertizës*		*Data e dorëzimit të raportit*

N. 105, LPP - Baza ligjore e shqyrtimit

Me datën **25.02.2017**, Organi Shqyrtues i Prokurimit ka pranuar ankesën me nr. **27/17,** e parashtruar nga OE **NTP "PRIMA ENGINEERING"** me seli në Prishtine, lidhur me aktivitetin të prokurimit **"Hartimi i hartes zonale per Komunen e Prizrenit"** me nr. të Prokurimit: **622 16 109 421**, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – **"Komunës së Prizreni".**

Konform nenit 113.1, te LPP-se Nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me Lgjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, eksperti shqyrtues e ka shqyrtuar dhe analizuar lëndën e (AK) – **Komuna Prizren.**

N.111,LPP - Operatori Ekonomik Ankues NTP "PRIMA ENGINEERING" me seli në Prishtine.

Pikat e Ankesës nga OE **NTP "PRIMA ENGINEERING"** nga **Prishtina**, *dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues:*

Neni 7 - Barazia ne Trajtim/ Jo-Diskriminimi
Neni 59 - Ekzaminimi, Vleresimi dhe Krahasimi i Tendereve
Vendimi I OSHP-se; PSH.408/16, I dates 30.12.2016

Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet:

Përmes kësaj shkrese ne si OE ankohemi lidhur me mosrespektimin e vendimit PSH. Nr.408/2016 të datës 30.12.2016 të OSHP-së nga ana e Autoritetit Kontraktues - Komunëssë Prizrenit.

Me vendimin PSH. Nr.408/2016 të datës 30.12.2016, Organi Shqyrtues i Prokurimit obligon Autoritetin Kontraktues - Komunën e Prizrenit që të anulojë njoftimin për rezultatet e konkursit të projektimit për aktivitetin e prokurimit "Hartimi i hartës Zonale për komunën e Prizrenit" me nr.prokurimi 622/16/109/421 dhe lënda kthehet në RIVLERËSIM prej fazës pas dorëzimit të vendimit të Jurisë.

Në vendimin e OSHP-së, Paneli Shqyrtues ka konstatuar se OE ankues "Prima Engineering" ka arritur të dëshmojë bindshëm se ka interes material juridik për këtë aktivitet të prokurimit, ndërsa në anën tjetër AK lidhur me operatorin e rekomanduar për kontratë nuk e bindi me prova dhe fakte panelin shqyrtues se OE i rekomanduar për kontratë ka interes juridik material konform nenit 111 të LPP-së.

Pas këtij vendimi, saktësisht pas 12 ditësh të punës, Autoriteti Kontraktues duke mos e

respektuar vendimin e OSHP-së dhe obligimet dhe që dalin nga ky vendim, e anuloi tërësisht aktivitetin e prokurimit "Hartimi i hartës zonale për komunën e Prizrenit", duke dhënë arsyetime të pabazuara për kinse mungesë mjetesh buxhetore për realizimin e këtij projekti kapital për zhvillimin e Prizrenit, edhepse vetë AK vetëm disa kohë më parë e kishte shpallur fitues një OE i cili kishte ofertuar me 186 mijë euro, pra një OE që ishte më i shtrenjtë se OE ankues për 51 mijë euro.

Ky arsyetim i AK-së që është përdorur për anulimin e këtij AP është i paqëndrueshëm për këto arsye, të cilat ne si OE ankues i kemi prezentuar edhe në kërkesën për rishqyrtim që e kemi bërë në Autoritetin Kontraktues, para dorëzimit të kësaj ankese:

1. Në Deklaratën e nevojave lidhur me këtë projekt, të nënshkruara nga zyrtari kërkues (Departamenti kërkues), Nijazi Kryeziu, nga zyrtari kryesor financiar, Zenel Ahmetaj dhe nga zyrtari kryesor administrativ, kryetari i komunës, Ramadan Muja, fillimisht me datën 16.05.2016, përkatësisht 17.05.2016 dhe në fund me datë 24.10.2016, shihet qartë që vlera e parashikuar për hartimin e këtij projekti është 185 mijë euro (Ne si OE ankues gjatë qasjes në dokumente publike që na është lejuar nga Zyra e Prokurimit e AK-së kemi pasur qasje në këtë Deklaratë të nevojave dhe e posedojmë një kopje të saj);

2. Në Tabelat Buxhetore të Buxhetit të Kosovës, përkatësisht në Tabelën 4.2 Financimi i Investimeve Kapitale Komunale 2016-2018(Datë 18.12.2015), buxheti për këtë projekt për vitet 2017 dhe 2018 në total është 170 mijë euro;

Duhet vënë në pah se ky aktivitet i prokurimit është shpallur gjatë vitit 2016 (madje është shpallur dy herë) dhe duke ditur që buxheti për realizimin e këtij aktiviteti të prokurimit është përcaktuar që në procedurat inicuese të këtij aktiviteti të prokurimit (pra në vitin 2016), dhe mbi të gjitha duke ditur që OSHP në vendimin e saj pas analizimit të tërë dokumentacionit të këtij aktivieti të prokurimit ka obliguar AK-në që këtë aktivitet të prokurimit ta kthejë në RIVLERËSIM (duke potencuar saktësisht se OE ankues ka interes material juridik për këtë aktivitet prokurimi), që do të thotë se OSHP nuk ka gjetur asnjë arsye të bazuar që ky aktivitet të shkojë në RITENDERIM apo të anluohet tërësisht, por të vazhdojë tutje për tu implementuar si projekt.

Po ashtu, duke shtuar këtu edhe faktin se Drejtoria e Planifikimit Urban ka edhe të ardhura vetanake që mblidhen nga pagesa e lejeve të ndërtimit dhe nga pagesa e shërbimeve tjera për këtë drejtori, dhe duke ditur se Harta. Zonale e Komunës së Prizrenit nëse do të fillojë të hartohet nga muaji shkurt apo mars (varësisht nga përfundimi i procedurave të prokurimit) i bie që ky projekt do të përfundojë në shkurt apo mars të vitit 2018 (1 vit kalendarik, ashtu siç kërkohet në Dosjen e Konkursit të Projektimit), del se mjetet financiare për pagesën e këtij projekti jetik për Komunën e Prizrenit janë të Sigurlara.

Pra, është i pa bazuar ligjërisht vendimi i AK-së për anulimin e këtij aktiviteti të prokurimit, në gjysmë të procesit, edhepse pikërisht i njëjti aktivitet prokurimi është inicuar dhe ka vazhduar deri më tani bazuar në Deklaratën e Nevojave, ku shihet qartë se janë të siguruara 185 mijë euro.

Pretendimet e Autoritetit Kontraktues qysh gjatë procesit të shqyrtimit të ankesës sonë të

parë lidhur me këtë AP ku AK-ja me çdo kusht tentonte të mbronte vendimin e saj për shpalljen fitues të OE të rekomanduar për kontratë, edhe pse ekspertiza e OSHP-së konfirmonte argumentet e pakontestueshme për shkeljen e dispozitave ligjore të LPP-së nga AK-ja lidhur me OE e rekomanduar për kontratë, dhe tani në rastin konkret, shpikja e "arsyeve" tjera që me çdo kusht ta anulojë këtë aktivitet prokurimi dëshmojnë më së miri për mungesën e seriozitetit dhe konsistencës së AK-së dhe për shkeljen e vazhdueshme të dispozitave ligjorete LPP-sé.

Kërkojmë nga OSHP që në bazë të kompetencave të veta ligjore që rrjedhin nga Ligji i Prokurimit Publik, të obligojë AK-në - Komunën e Prizrenit që të respektojë dhe të zbatojë vendimin e OSHP-së lidhur me këtë AP dhe pas rivlerësimit të shpallet fituesi i i këtij Aktiviteti të Prokurimit.

Dëmet materiale

Dëmet materiale të shkaktuara nga ky vlerësim diskriminues janë shpenzimet për hartimin e propozimit teknik nga stafi i dy kompanive, si dhe koha e humbur, që përfshijnë së paku një shumë prej 5000 eurosh, si dhe shpenzimet lidhur me përgatitjen e ankesës lidhur me këtë konkurs projektimi që përfshijnë shumën prej 1500 eurosh.

Procesi i prokurimit:

Data e njoftimit për kontratë në KRPP :	29.08.2016
Lloji i procedurës së aplikuar:	Procedurë e hapur
Lloji dhe vlera e kontratës së publikuar:	konkurs projektimi/vlerë e mesme
Afati i fundit për dorëzimin e ofertave, pas szgjatjes se afatit,	19.09.2016
Data e hapjes se ofertave sipas procesverbalit,	26.09.2016
Data e njoftimit mbi rezultatet e konkursit	31.10.2016
Data e njoftimit per anulim te AP, ne krpp	19.01.2016

Kriteret për vlerësim

III.2.1) Kërkesat e përshtatshmërisë:

- Operatori Ekonomik duhet të përmbushë kërkesat e specifikuara në nenin 65 të Ligjit të Prokurimit Publik (LPP),

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

1. Deklaratat nën betim se operatori ekonomik përmbush kërkesat mbi përshtatshmërinë të LPP-se, Neni 65, siç është e cekur ne piken a deri ne i do të dorëzohen në formë të Aneksit
2. Një vërtetim i lëshuar nga gjykata kompetente apo autoritetet administrative të vendit të themelimit të tenderuesitper piken j deri ne q .
3. Një vërtetim i nënshkruar nga Administrata tatimore e vendit të themelimit të Operatorit ekonomik, se Operatori ekonomik në fjalë nuk është me vonesë ne pagimin e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit të vitit para dorëzimit të tenderit.

Për piken 2 dhe 3 kërkohet vetëm nga Operatori ekonomik qe propozohet për dhënien e kontratës

III.2.2 Përshtatshmëria profesionale
Kërkesa:

1. Regjistrimi si operator ekonomik në regjistrin profesional, komercial dhe/apo regjistrin e ndërmarrjeve në vendin e juaj të themelimit;
2. Regjistrimi i TVSH;
3. Regjistrimi i numrit fiskal;

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

1. Një dokument i lëshuar nga autoriteti përkatës publik në vendin e themelimit të operatorit ekonomik
me të cilin evidentohet regjistrimi i operatorit ekonomik në atë vend (Kopja e çertifikatës së biznesit);
2. Kopja e TVSH-se;
3. Kopja e numrit fiscal

III.2.3) Kapaciteti ekonomik dhe financiar **N/A**
III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional

1. Autenticitetit i produkteve dhe cilësisë reprezentues
2. Certifikatë të produkteve në lidhje me përshtatjen dhe specifikat ose standardet
3. Katalogë/pjese te katalogut, përshkrimeve, prezantimeve grafike dhe/ose fotografive dhe vizatime të produkteve që duhet të furnizohen

Dëshmia e kërkuar dokumentare

1. Autorizim nga prodhuesi ose dileri i autorizuar (nëse autorizimi është nga dileri atëherë si dëshmi te sillet kontratë ose autorizimit mes dilerit dhe prodhuesit), për shitjen e produkteve qe ofroni.

2. Certifikatë ISO 9001:2008 te prodhuesit për produktet e ofruara.

Katalogë apo pjese te katalogut dhe vizatime te vërtetuara nga prodhuesi me përshkrimet teknike detale për te gjithë artikujt qe ofertoni(paisjet e oferuar te jene te nënvizuara ne katalog);

Regjistri i ofertuesve sipas procesverbalit të hapjes publike (N.58):

Nr.	Tenderuesi	Vendi	Çmimi	Vërtetje
1	"SMART PROJEKT" N.P.SH	Prishtinë	186,000.00€	JO
2	NTP "PRIMA ENGINEERING"	Prishtinë	135,000.00€	JO
3	"DIARKO" SH.P.K	Prishtinë	145,000.00€	JO
4	"HIDRO ING-DK" SH.P.K	Prishtinë	158,746.00€	JO
5	"P.L.A.N.2 & ABKONS" SH.P.K	Prishtinë	78,000.00€	JO

Në këtë aktivitet të prokurimit kanë marrë pjesë tri (5) operator ekonomik, në procesverbal të hapjes nuk është rexhistruar asnjë vërejtje në lidhje me hapjes e ofertave.

Komisioni vlerësues pranë AK:

Përbërja dhe kualifikimi i komisionit vlerësues.

Autoriteti Kontraktues për vlerësimin e tenderëve ka caktuar komisionin në përbërje prej tre anëtarëve, si në vijim:

- - Kryetar i komisionit – Shpresa OSMANOLLAJ
- - Anëtar i komisionit - Skodran KRYEZIU
- - Anëtar i komisionit – Muhamet KURTAJ

Data e mbarimit të vlerësimit: 26.09.2016

Data e nënshkrimit te raportit nga zyrtari kryesor i prokurimit:.....26.09.2016

Raporti i komisionit vlerësues:

Kriteret qe jane aplikuar:

1 - Propozimi teknik - 70%

2 - Propozimi financiar - 30%

Emri i OE	Poenat teknike	Cmimi	Poenat financiare	Totali i poenave
"SMART PROJEKT" N.P.SH	69.54	186,000.00€	12.58	82.12
NTP "PRIMA ENGINEERING"	58.87	135,000.00€	17.34	76.21
"DIARKO" SH.P.K	49.94	145,000.00€	16.14	66.08
"HIDRO ING-DK" SH.P.K	Prishtinë	158,746.00€	14.74	67.26
"P.L.A.N.2 & ABKONS" SH.P.K	Prishtinë	78,000.00€	30.00	61.04

Komisioni ri-vlerësues pranë AK:

Përbërja dhe kualifikimi i komisionit ri -vlerësues.

Autoriteti Kontraktues për ri- vlerësimin e tenderëve ka caktuar komisionin në përbërje prej tre anëtarëve, si në vijim:

- Kryetar i komisionit – Aferdita Mormurina
- Anëtar i komisionit - Refki Musbegu
- Anëtar i komisionit – Arben Shala

Data e mbarimit të vlerësimit: 13.01.2017

Data e nënshkrimit te raportit nga zyrtari kryesor i prokurimit:.....13.01.2017

Raporti i komisionit vlerësues:

Komisioni ka bere rivleresimin e ofertave dhe konstaton :

OE "Smart Projekt, Prima Ingjinjering, Diarko dhe Hidroinf DK, kanë cmime ofertuese mbi 125.000€, te cilat bien ndesh me proceduren e shpallur (konkurs me vlere te mesme)

OE AB Kons, nuk ka marr 70%, të 70 poenave teknike (49 poena) por ka marr 44.33 andaj ky eshte i pa pergjegjeshem komisioni rekomandon qe ky tender te anulohet.

Analiza dhe konstatimet e ekspertit shqyrtues - Teknik (N. 306)

Eksperti shqyrtues - teknik, pas ekzaminimit të dosjes së tenderit, shqyrtimit të rrjedhës së procedurës së tenderimit dhe pretendimeve të palës në ankesë sqaron me sa vijon:

Sqarimi nr. 1 Autoriteti Kontraktues - "Komuna Prizren", gjatë këtij aktiviteti të prokurimit ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës është konkurs projektimi, kontratë publike me vlerë të mesme, operatori ekonomik ankues: NTP **"Prima Inginering"**, ka parashtruar ankesë në këtë aktivitet të prokurimit kundër njoftimit mbi anulimin e konkursit të projektimit, pas vendimit te panelit shqyrtues me nr. 408/16, te dates 21.12.2016, konkretisht pas ri-vleresimit te ofertave, ku AK – Komuna Prizren ne njoftimin për anulim tekstualisht ka cituar: *"Te gjithe tendertet e përgjegjëshëm përmbajnë cmime të cilat në masë substanciale e tejkalojnë buxhetin e AK-së, për aktivitetin e prokurimit; OE "Smart Projekt, Prima Ingjinjering, Diarko dhe Hidroinf DK, kanë cmime ofertuese më të larta se **120,000.00 €**, ndërsa tenderi shërbim vlerë e mesme, ndërsa OE AB Kons, në vlerësimin teknik nuk ka marr 70%, të 70 poenave që i bie 49 poena por ka marr 44.33 poena gjë që e bënë edhe këtë të pa përgjegjëshëm"*

Kunder të njejtit anulim prashtruesi i ankesës OE "NTP **"Prima Inginering"**, sipas datës së përshkruar me 20.01.2017, ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim pranë AK-së, me pretendimet ankimore se AK ka bërë shkelje të nenit. 7,dhe 59, të LPP-se, poashtu nuk është respektuar vendimi i OSHP-se , nr.408/16, i datës 30.12.2016.
AK – Komuna Prizren, më datën 23.01.2017, nxjerr Vendim dhe refuzon kërkesën për rishqyrtimi, me arsyetimin si në njoftim për anulim të këtijë aktiviteti të prokurimit.

Sqarimi nr 2 Ekspertet e OSHP-së, arsyetimin e anulimit të aktivitetit të prokurimit si dhe arsyetimin e vendimit të AK-së, kundrejt kërkesës për rishqyrtim e kualifikojnë si të pa bazuar pasi që në shkresa të lëndës së AK-së, ekziston kopja e deklaratës dhe disponueshmeria e fondeve për këtë aktivitet të prokurimi dhe atë në vlerë prej **185,000.00 €**, e aprovuar nga ZKA dhe ZKF, i autoritetit kontrakues – Komuna Prizren.

Mendimi i ekspertët e OSHP-se:

Ekspertët e OSHP-se, bazuar në sqarimet e cekura në raport i propozojne Panelit shqyrtues që aktiviteti i prokurimit **"Hartimi i hartes zonale per Komunen e Prizrenit"**, me nr. të Prokurimit: **622 16 109 421**, të kthehet në **RIVLERESIM**, ndërsa ankesa e OE **NTP "PRIMA ENGINEERING"**, të aprovohet si e **bazuar.**